


№ 2/1977

89.24



Shtyp Ndërmarrja shtypëshkronjëse grafike »Progres«
Mitrovicë

1000 copë



N^o 2/1977?

Organ e shqiptarë se mësimjeve të mesreses
 "Alaud-din" në Prishtinë
 Del kësaj munde



بَاجِرَامِ سُبَّانِكُ الْإِسْلَامِ

REDAKSIA E REVISTËS "NUR" TË
GJITHË LEXUESVE, BASHKËPUNËTORVE DHE TË GJITHË
ITHTARVE TË BASHKËSIS ISLAME UA URON DHE IU DE-
SHIRON DITË FATËLUME ME RASTIN E FESTËS SË

KURBANBAJRAMI T

إِنَّا عَطَيْنَاكَ الْكُورْ

BAJRAMI I KURBANIT

Kurban bajrami, më mirë me thënë bajrami i haxhit, na e paraqet bilancin e veprave tona të arritura gjatë një viti, lëshimet dhe detyrat e reja. Atëherë së bashku në të gjitha niveot, duke filluar prej xhematit më të vogël të fshatit, nëpërmjet të xhematit më të madhë të qytetit, e gjer në tubimin më të madhë islam në Meke-haxh, në mënyrë më serioze merren në shqyrtim veprat e kaluara,

zulmi-lavdi dhe sukseset, njëkohësishtë duke menduar edhe për vështërsit dhe përgatitjet për detyrat që na presin.

Në këtë vit bajramin e kurbanit, e festojmë në shenjë të sukseseve të dukshme, por dhe në shenjë të detyrave të mëdha që na presin dhe drejt për së drejti qëndrojnë para nesh, duke pretenduar prej neve orvatje dhe flijime altroiike-të singerta matëryjale, gjith-

sesi brenda kufijve të mundësive tona, të cilat duke iu falenderuar Zotit janë në nivel të duhur.

Sa i përket festës së bajramit të kurbanit, është e udhës që një kujdes të posaqëm tia kushtojmë qëllimit, obligimit, rëndësisë si dhe tjerave nevoja rreth prerjes së kurbanit. Këtë e bëjmë për arsye se shumë njerëz, nuk e njohin në përpikëri (hollësi) qëllimin e këtij obligimi fetar, duke u turpërua ta pyetin atë që e din, veprojnë sipas hamendjes dhe kështu në shumë raste gabojnë. Disa prej tyre, psh. prej kurbanit për të vdekurin (vasijetporosi) në bazë të njëfarë gjykimi të tyre, në vigjiljen-në prak të bajramit, gjë që asesi nuk është e vlefshme. Disa, edhe pse janë të obliguar të prejnin kurban, nuk e bëjnë ate duke e llogaritur se ajo nuk është aq e obliguar apo porositur.

Disa të tjerë prap, prejnin kurban për gruan dhe fëmijë të vetë e në këtë mënyrë ngarkojnë vehtën me atë që se kanë për detyrë. E për këtë na, shkurtimisht do të përpiepi që tua bëjmë të mundshme atyre që nuk dinë, që nga ky artikull të njoftohen së paku me atë që kanë nevojë.

Prerja e kurbanit është urdhër (vaxhib) i Zotit xh. sh. si që shihet edhe nga kjo kapitull e Kuranit e cila thekson:

»INNA EA 'TAJNAKEL-KEV'THER FESAL-LI LI-RABBIKE VENHAR INNE SHANIEKE HUVEL-EBTER«.

»Me të vërtetë të kemi dhënë ty (O Muhamed) të mira të pakufishme (Kuranin, profetisinë, shefatin) prandej falju (luftju) Zotit tënd dhe prej kurban. Me të vërtetë ata, të cilët të urejnë ty, janë »ebter« që don të thotë ata janë pa kurrfarë dobie dhe të mirë«.

Kjo sure i ka zbritur M. a. s. me rastin kur njëri ndër kundërshtarët e Profetit As ibni Velidi, pas vdekjes së djalit të M. a. s. — Kasimit, i thotë se është »ebter« që don të thotë pa kurrfarë dobie dhe ardhmërie etj. Kjo sure i zbriti M. a. s. si ngushllim në këtë atak-sulm. Këtu flitet edhe se iu ka dhënë atij (M. a. s.) çdo e mirë në këtë dhe në botën e ardhshme, dhe se nuk duhet të deshpohet, sepse mu kjo cilësi e shëmtuar të cilën ia përshkruan kundërshtarët gjindët te vet ata.

Profeti a. s. pastaj tha, që në këtë kapitull me fjalën »falu« nënkuptojmë fjalën e namazeve të dy bajrameve, kurse me fjalën »preje« nënkuptohet prerja e kurbanit në namazin e kurbanit.

Edhe pse në Kuran nuk është theksuar koha dhe mënyra e prerjes së kurbanit, këto dy dispozita islame janë (vaxhib, që don të thotë se nuk është rrebtësisht e urdhëruar-farz.)

Bajrami i ramazanit si dhe ai i kurbanit janë dy kremtime më të mëdha vjetore për mbarë botën islame. Si në çdo rast, poashtu edhe në këtë Zoti xh. sh. i urdhëroi muslimanët e pasur, »që me rastin e kremtimit të këtyre ditëve të i përkujtojnë vllëzërit e tyre të vobektë dhe ti ndihmojnë në mënyrë që edhe ata ti kalojnë në mënyrë solemne këto ditë të bekuara, së bashku me vllëzërit e tyre. Për këtë arsye edhe u bë detyrë sadakai-fitri në atë të ramazanit, kurse prerja e kurbanit në kurban bajram. Si që është e njohur nga sejcili kurban një e treta e tij u takon të varfërve. E tani të shohim:

Kujt i është detyrë të prej kurban?

Vaxhib-detyrë për të prerë kurban e ka ai person, i cili e ka për detyrë të jepë sadakai-fitër në bajram të kurbanit.

Njeriu i cili e arrinë shumën totale (përgjithshme), ose vlerën më të vogël të kësaj shume (nisabin) nuk është i detyruar të jap s. fitër, e as që të prej kurban, por është më mirë që të bëjë ate, sepse M. a. s. në shumë raste e ka lavdrua këtë, duke thënë se Zoti xh. sh. premtën shpërblim të madhë. Sipas kësaj nëse dikujt para bajramit të ramazanit i tepron 10-20 din. (Sa është shuma më e vogël e s. fitrit) edhe pse se ka për detyrë, mirë është që ta jap s. fit. . Ose dikush ka 500-800 dinar para kurban bajramit, e kjo shumë i tepron pasi ti ketë plotësua nevojat e domoshme, mirë është që ai njeri ta prej kurbanin edhe pse nuk e ka vaxhib.

Si kurban mund të mirret: njëvjeçarë (dashi, delja, dhija etj.). Mundët edhe më i ri se një vjeçarë, qoftë gjashtë muajsh, por me kusht që të jetë i zhvilluar si ai një vjeçarë.

Mështjerra dyvjeqare (lopa, kau, devja etj.) mund të janë kurban për shtat persona, por me kusht që të gjithë të kenë për qëllim kurban dhe të gjithë në të të marrin nga një pjesë të barabart (të gjithë nga një të shtatën) prandej, nëse njëri prej tyre është shoqëruar për shkak të mishit ose një prej tyre është jo musliman, apo dikujt i bjen shuma më e vogël se një e shtata, ai kurban nuk do të jetë i vlerëshëm për asnjërin nga ata, po edhe në qofshin vetëm dy.

Mishi nga ky kurban duhet të ndahet në pjesë të njëjta.

Që kurbanit të jetë i vlershëm, nuk guxonë të jetë i verbët, po në qoftë edhe në njerin sy. Nuk guxon asë të jet i dobët (ligësht), asë sa nuk mundë të shkoj vetë në vendin e prerjes. Nuk guxonë ti mungojë asë njara këmbë, po ashtu ma tepër se gju-sma e veshit e asë e bishtit. Ndërsa nuk pengonë nëse e ka bririn e thyer.

Koha e therrjesë së kurbanit fillonë pas falëjesë të namazit të bajramit dhe zgjatë deri me prarimin e diellit të ditës së tretë. Kjo vëlenë për qytetët dhe fshatratë e mbë-dha, ku falët namazi i bajramit, ndërsa në vendet më të vogla ku nuk falët namazi i kurbanit, menjëherë pasi të paraqitet agimi i ditës së parë të bajramit.

Qe se si është qëndrimi i M. a. s. para prerjes së kurbanit. Profeti a. s. çdo vit e kryente këtë rit fetarë. I prejke nga dy desh të cilët e kishin nga një vit e disa muaj. Tra-dit e ka patur M. a. s. që menjëherë pas kryerjes së namazit të bajramit ta prej kur-banin. Ai porositte që kurbanit të jetë i ma-jmë, i shëndoshë dhe pa kurrfar të mete tru-pore prej atyre që u cekën më lartë.

Thuhet nga Xhabiri r. a. »Kur M. a. s. e kryente namazin e bajramit pastaj mbante hutbën e pasi e kryente ate urdhëronte me-njëherë që të ia sjellin kurbanat e tij, të cilët i prente duke thënë:

»Bismil-lahi all-llahu ekber hadha min ve'amen lem jedahha min ummeti«. »Në emër të Zotit, Zoti është më i madhi. Ky është kurban për mua dhe për pasardhësit e mij të cilët nuk kanë pre kurban.«

Në sunën të Ebi Davudit qëndron edhe kjo: Se M. a. s. para se ta prente kurbanin i falte dy rekatë, e kur bëntë ta prente kur-banin thonte edhe këtë: »Vexhxhehtu vexhhi lil-ledhi fetares semavati vel-erda hanifen ve ma ene minel-mushkrikine. Inne salati ve nusuki ve mehjahe ve nemati lil-lahi rabbil-alemine. La sherike lehu ve bi-dhalike umi-rtu ve ene minel-muslimine. All-llahumme minke ve leke an Muhammedin ve ummeti-hi bismil-lahi All-llahu ekber« Që don të thotë:

»E kthej fytyrën time ndaj ati, i cili i krijoi qiellrat dhe tokën, duke u larguar nga çdo fe tjetër e gabuar. Unë nuk jamë prej pabesimtarëve. Namazi i im dhe ibadetet tje-ra, jeta ime dhe vdekja janë vetëm për Zotin, krijuesit të botrave. Ai nuk ka shok. Këtë ma ka urdhërua dhe unë atij i përulëm. O Zot! Ky është (kurban) prej teje, ja pra Ty ta flijoj, për vehte dhe për umetin tim. Në emër të Zotit, Zoti është më i madhi.«

Muhamedi a. s. i këshillonte njerëzit që të silleshin mirë me kurbanat e tyre para prerjes dhe ja çka thonte: »Zoti ju ka urdhë-ruar bëmirsë në çdo punë, po edhe kur të preni kurban silluni mirë ndaj tij«. Prej bë-mirsive të cekura është edhe ajo që një kurban të mos pritët në prezencën e tjetrit, të mos ripet para se të ç'fryhet etj.. Kur Muhamedi a. s. e prente kurbanin e tij, me-njëherë iu a ndante të varfërve në atë vend dhe thonte: »Kujt i nevoitet le të merr sa të doj.«

Pra mishi i kurbanit duhet të ndahet si-pas hadithit, që don të thotë një të tretën ta ndaj në mes të familjës së gjërë, po edhe në qoftë e pasur, sepse ajo është hedije-dhu-ratë e jo sadakë-lëmoshë; një të tretën do tua ndajë të varfërve, e një të tretën do ta mbaj për vehte.

Ka kurbanat, të cilët në tërësi duhet ndarë të varfërve. Të tillë janë kurbanat të cilët prehen sipas porosisë apo testamentit. Ky lloj kurbanit vasi-muhtar, ose ai i cili e kryen porosinë, duhet ta prej kurbanin dhe në tër-si tua ndaj varfnjakëve, ose tia dhuroi një të varfëri e ai ta prej në shtëpi të vetë.

Nëse kurbanit prehet për një të vdekur, e ai të mos e ketë lënë amanetë, atëherë ai nuk duhet të ndahet i tërë, por mund të nda-lët edhe për vehte diç, por është më e lavdua-shme që me atë rast të ndahet i tërë.

Më së miri është që njeriu vet ta pret kurbanin e vet. Nëse nuk din ose i është punë jo komode, me këtë rast së paku ai nevoitet që të prezentoj gjatë prerjes së tij.

Lëkura e kurbanit, e edhe pjesët tjera (nëse nuk mendojmë ti ndalim për vehte) duhet ti jipën ndonjë të varfëri e jo me e shit si që është zakon tek ne, sepse M. a. s. thotë:

»Men ba'a xhilde ud'hijjetihi fela udhi-jjete lehu.«

»Kush e shet lëkurën e kurbanit të tij, konsiderohet sikur të mos e kish prerë fare.«

Por për tu shmangur nga ky gabim kaq i madhë që mund ta bëjmë nëse veprojmë kështu (me shitjen e lëkurës), atëherë lexuas të nderuar bashkohuni akcionit dhe lëkurat e kurbanave tuaj dërgoni për mbajtjen e me-dresës së mesme »Alaudin«, me të cilin rast do të bëni një gjest human dhe do të ju mundësoni nxënësve të saj që ti mbulojnë nevojat materjale. Sepse si që e dini edhe ju vetë ky ent i vetëm fetar në krahinë, fu-nkcionon dhe jeton duke iu falenderuar ndi-hmave vullnetare të besimtarëve të cilët kohë

pas kohe i dërgojnë me aq sa kanë mundësi dhe kështu kontribuojnë mjaftë. Andaj shfrytëzojmë rastin që ti falenderojmë të gjithë ata të cilët e ndihmuan, e njëherit edhe ata të cilët kanë ndërmend që ta bëjnë një gjë të tillë të gjithëve ju shprehim falenderime të sinqerta.

Kur u bë detyrë kurbanit?

Për të sqaruar në hollësi këtë pyetje, patjetër na duhet të kthehemi dhe të bëjmë një vështrim në kohën e Ibrahimit a. s., kur edhe u qfaqë për herë të parë kjo detyrë. Atbotë Ibrahim a. s. për një kohë të gjatë nuk pati femi dhe gjithnjë e lutte Zotin që t'ia falte një. Zoti i gjithfuqishëm, lutjen e tij e pranoi dhe i fali një femi të cilin ky e pagëzoi me emrin Ismail. Pasiqë dëshira e flakët për të patur femi u plotësua, kjo njëherit edhe është gjëja më e rëndësishme e jetës së tij. Ky kishte bindje të fortë në Zotin xh. sh. e me plotësimin e dëshirës së tij, kjo bindje u rrënojës edhe më tepër ke ai. E për ta provuar Zoti besimin e tij, kërkoi nga ai të flijonte Ismailin të cilin aq kohë e kishte dëshiruar.

Ja pra se si këtë na e përshkruan Kurani:

»Dhe kur u rritë (Ismaili) që (me të jatin Ibrahimin) të fitonte në tregëti, i thotë Ibrahim: »O biri im, unë kamë andërruar

që të të dhuroi si flijim, e ti çka mendon?« Ai u përgjeggjë: »O babai im, puno çka të është urdhëruar, me të vërtetë me emër të Zotit do të bindësh se sa do të jamë unë i duruashëm.« Pasi iu nënshtruan urdhërit (Ibrahimi) e largoi (Ismailin) me një anë, (vërtetuam te ai gatishmëri që ta flijoi birin e tij) dhe e thirrëm Ne atë: »O Ibrahim ti e plotësove ëndrrën. Ne me të vërtetë në këtë mënyrë i gradojmë bëmirsat. Me të vërtetë kjo është një provë.« KUR'AN

Duke e flijua të birin e vet Ibrahim a. s. e tregoi se besimi në të Gjithfuqishmin i është më i afërt se dashuria familjare, në anën tjetër Ismaili a. s. pa u lëkundur fare që i gatshëm ta jep gjënë e tij më të qmuar — jetën. Për flijime të tilla Zoti nuk kishte nevojë. Ishte e nevojshme të shprehet gatishmëria që të flijohet, e cila do tu mbetet si shembull pasardhësve. Zoti e ka mëshirën të pakufishme dhe Ai në vend të Ismailit caktoi si flijim të kurbanit — një dash të madhë.

Islamizmi e përvehtsoi këtë detyrë në shenjë kujtimi në Ibrahimin a. s. dhe birin e tij Ismailin dhe e caktoi si detyrë të domosdoshme për çdo musliman të rritur dhe të pasur.

MIFTAR AJDINI e SELIM RUSHITI

viti — V —

ISLAMI NUK ËSHTË KUNDËR EMAN- CIPIMIT TË FEMRËS DHE PËRPARI- MIT TË NJERIUT NË PËRGJITHSI

Nëse ndalemi dhe i bëjmë një vështrim të shkurtër së kaluarës e posaqërisht vendeve ku edhe u shpallë kjo fe-Gadishullit arabik, pa mëdyshje do ti miratojmë fjalët e lartëshenuara në titull.

Ka kaluar një periudhë e gjatë, plotë 14 shekuj. Ishte koha kur tër njerzisë e kishte kapluar errësira. Ishte ky terr i mosdijes, kur njerëzit ishin largua nga normat

të mëdha, ishin në vuajtje të pa përshkruara, njerzore, kishin humbur besimin e drejtë, e në vend të tij ishin pais me besime të kota; kishin ra në gradën më të ulët të moralit sepse në lutjet që bënin iu përulëshin idoleve të ndryshme dhe gjërave të kota. Në këto kushte bota femrore përjetonte padrejtësira të mëdha, ishin në vuajtje të papërshkruara, pa kurrfar të drejtash, dhe nuk konsideroeshin si partner të barabartë me njerzit tjerë.

Femrat ishin të urrejtura nga të gjithë njerëzit e bile edhe nga prindërit e tyre. Ata me lindjen e fëmijut të tyre femër, menjëherë çfaqin pakënaqësi dhe urrejtje ndaj tij, duke konsideruar ruajtjen e tij si turp. Me këtë mendim ata bënë varrosjen e tyre për së gjalli.

Nga shkaqet e përmendura, por ka edhe shumë të tjera të pa theksuara, u ndie nevoja për një reformë e cila do ti çrrënjosi këto konzervatizma, për një sistem të rinjë me rregulla të reja, që do ti shërbente njerzimit për të dalur nga errësira, nga rruga që të shpie në humnerë, e ti drejtoi ata kah drita dhe shpëtimi, drita e cila u pritë me padurim nga masa e gjërë, e kjo ishte shpallja e cila i zbriti Muhamedit, njëri nga mesi i tyre.

Profeti a. s. misjonin e tij hyjnor të cilin ia ngarkoi Perendija arriti ta kryej me ndërrë. Ai me punë të pa lodhur dhe sistematike, ia doli në krye që tër njerziteti të nxjerri në dritë, me një fjalë u bë një revolucion i plotë në çdo pikëparje, si kultural, moral e t.j. Prandaj Muhamedin a. s. lirisht mundë ta quajmë reformator më të madhë të historisë njerëzore. Në kohën e tij u vunë themelet — zanafilla e të gjitha virtyteve të jetës së lumtur njerëzore. Ishte kjo koha kur morali kishte arritur kulmin, baza e të cilit ishte shpallja e Perendisë-Kurani.

Me shpalljen e islamit mes tjerash edhe çështja e femrës u rregullua, edhe asaj iu dhanë të drejtat që i takojnë. Kjo në shoqërinë islame mori pozitën përkatëse, respektivisht, u bë partner i barabartë në shoqëri. Andaj në sajë të këtyre reformave arabët u ngritën në një nivel aq të lartë sa që u bënë shembull në çdo pikëpamje për mbarë njerzitetin. Kur popujt tjerë në viset e ndryshme të botës gjëndeshin në një skamje-mjerim, nuk dinin kah të orjentoreshin, ndërsa arabët në shkollat e tyre mësonin astronominë e shumë shkenca të tjera, për të cilat evropjanët as që kishin dëgjuar.

Gjersa vazhduan në këtë mënyrë ata edhe përparonin, mirëpo kur filluan ti lëshojnë parimet islame, dhe të mos iu përmbahën atyre filluan të stagnojnë dhe të ngelin prapa. Nga ana tjetër kishte njerz që e përqaфонin, por kishte shumë edhe asish që e urrenin dhe e kundërshtonin fenë islame. Andaj këta njerz që nga fillimi tentonin të ia humbnin vlerën e saj, ta zhdukën atë, dhe të përtrijnin ideologjitë e tyre të më parme të cilave iu humbi vlera me ardhjen e islamit.

Në këtë ata gjer diku edhe patën sukses, arritën që ta mashtrojnë masën e gjërë e cila ende nuk kishte arritur në tërësi të i përvehtësonte dhe të njëhej me bazat e fesë. Nga ana tjetër edhe nuk i dinin qëllimet e tyre tendencioze.

Kështuqë dijetarëve islam iu dual një detyrë e re dhe tejet delikate. Ata menjëherë ia filluan punës së tyre, duke i luftuar rrebtë këto gjeje uragante të armiqve të islamit të cilët me çdo kusht synonin të ia arrinin qëllimit. Qëllimi i tyre ishte; ta bindin masën e gjërë, duke i këshillua që të jetonin thjeshtë, mos të shkolloheshin, dhe sa më shumë të vuanin në këtë botë, në jetën e amshuar do të përjetojnë kënaqësi, gjoja se të gjitha këto, në këtë mënyrë, i porositi islami. Ata me këto qëllime tendencioze, tentonin që ti mbanin nën këmbë masën e gjërë të popullit dhe bënë eksploatimin e tyre, duke i bindur ata me predikime të rrejshme, të cilat i veshnin me petkun islam, megjithëse ato ishin krejtë në kundërshtim me te. Për këtë islami i hudhë poshtë këto, ngase janë të pa baza dhe të vendura nga hipokritët të cilët verbalisht e në mënyrë dogmatike u orvatën, por nuk korren sukses, andaj edhe nuk ju veshi.

Disa njerz edhe në ditët e sotme, megjithëse pa kurrfar të drejte shprehin duke thënë se islami është shkaktarë për prapambeturinë e njerzimit në kohën e sotme, shkaku është se këta njerz nuk njihen me bazat e fesë dhe se nuk kanë lexuar literaturë të nevojshme islame. Përkundër mendimit të këtyre, islami porositi mësim, studim dhe përparim, të cilën gjë na e argumenton edhe shpallja e shenjët e cila nuk filloi me asnjë fjalë tjetër, por: »IKRE'BISMI RABBIKEL-LEDHI HALEKA...« që në komentim do të thotë: »LEXO, MËSO, STUDJO NË EMËR TË ZOTIT TËND I CILI TË KA KRIJUAR TY...« Bash përkundrazi i prapambetur mbetet ai i cili nuk iu përmbahet këtyre urdhërave, e vepron ndryshe.

Për islamit që është përparimtar dhe që e urren injorancën, kuptojmë edhe nga aspekti se islami është tolerant dhe nuk lejon që në mënyrë dogmatike të përvehtësohen bazat e fesë, si bie fjala besimin në Zotin, cilësitë e tija, ringjalljen etj. por ai porositi që ato më parë të studjohen, gjykohen dhe nëse i pranon logjika e tij, të aprovohen dhe të veprohet me to.

Disa tendencioz të tjerë, megjithëse pa baza, u munduan që edhe qështjen e femrave — joemancipimin e tyre ia mbështetën islamit dhe e konsiderojnë si shkaktarë kry-

esor. Mirëpo këta njerëz nuk dijnë se islami është absolutisht kundër kësaj teorie, sepse ai (islami) nuk bën dallim në gjini por porositi që njeriu të eci kah progresi duke mos i dallua, e për këtë thotë: »VE LA TETEMENNU MA FEDDALELL-LLAHU BIHI BA'DUKUM ALA BA'DIN...« e që don të thotë: »Mos mendoni (mos keni shpresë) se Perendia e ka rrespektua njërin palë më tepër se tjetrën me te...«

Nëse marrim dhe i analizojmë fjalët e cituara, medoemos do të vijmë në përfundim se islami nuk bën dallim në mes të gjinive. Një gjë të tillë na e deshmon edhe ky verset i Kuranit: »FESTEXHABE LEHUN RABBUHUM INNI LA UDIU AMELE AMILIN MIN KUM MIN DHEKERIN EV UNTHA...« Që donë të thotë »Ju përgjegj Perendija (duke i thënë) me të vërtetë Unë nuk ia humbi punën e asnjë punëtori, meshkull apo femër qoftë...«

Hipokritët tentuan në mënyrë të ndryshme dhe në lëmi të ndryshme u orvatën ta çvlersojnë islamin, por ideologjia islame mbeti e pa tundur. Nuk janë raste të rralla, p.sh. kur islamit ti drejtojnë kritikë duke i thënë se ai e pengon diturinë dhe arsimimin në përgjithsi. Mirëpo të tillët nuk dijnë dhe nuk njohin se si dhe çka porositi islami, se përndryshe nuk do ta thonin një gjë të tillë. Për ilustrimin e kësaj që u theksua po i përmendim vetëm disa shembuj dhe do të bindemi se me të vërtetë nuk kanë të drejtë.

Perendija në Kuran thotë: »KUL HEL JESTEVIL-LEDHINE JALEMUNE VEL-LE-

DHINE LA JALEMUNE...« Thua (O Muhammed) a krahasohen ata të cilët dijnë me ata të cilët nuk dijnë...«

Profeti a. s. thotë: »TALEBUL ILMI FERIDATUN ALA KUL-LI MUSLIMIN VE MUSLIMETIN...« Që don të thotë: »KËRKIMI I diturisë është detyrë e çdo muslimani dhe muslimaneje«. Pastaj: »UTLUBUL ILME VE LEV KANE FIS-SINI...« që donë të thotë: »Kërkoje diturinë, po edhe në qoftë në Kinë«. Përveç kësaj, se sa rëndësi muslimanët i kanë dhënë diturisë, një gjë të tillë e kuptojmë edhe nga praktika e muslimanve të parë. Rast të tillë kemi kur muslimanët në luftë me mushkrikët i nxunë robë më se 70 veta. Pasi shumica prej tyre dinin shkrim-lëximi aherë ata nuk i denuan me vdekje si që ishte zakoni, por Profeti pranoi që çdonjëri prej tyre ti mësoi nga 10. fëmij muslimanë shkrim e lexim dhe kështu të lirohet nga robëria. Vetëm ky shembull mjafton dhe nuk ka nevojë të përdorim ilustrime tjera, për të vërtetua se me të vërtetë islami është progresiv dhe urdhëron — predikon diturinë e në anën tjetër e lufton injorancën dhe paditurinë e njerzive.

Andej të gjithë muslimanëve iu deshironjë sukses dhe deshironjë ti shohim të udhëhequr në rrugën e besimtarve të parë, të cilët ishin shembull në çdo lëmi. Dhe detyrë (dhe e gjithë neve) është që të denancojnë çdo tendencë (dukuri negative) dhe të demantojnë ideologjinë e pastër islame...

Miftar. AJDINI kl. V.

ISLAMIT

Edhe arabët e mjerë,
ikur edhe popujt tjerë
që jetonin aherë,
të pa dijshtëm ishin që të tër.

Për kulturë nuk dinin fare
e as mëshirë nuk kishin,
sepse femrat në varre
i shtinin posa lindënin.

Edhe shumë të tjera punë
që nuk duhet të punohen,
në këtë kohë patën fillua
e që duhej të ndalohen.

Për këtë gjë Perendija
bëri mëshirë mbi njerëzinë,
të dashurit të tij Lartëmadhërija
ja dërgoi profetësinë.

Muhamedi ishte i dashuri i tij,
ai vazhdimisht, pa u lodhë punojë
dhe qëllimit ia arriti
në rrugë të drejtë njerzët ti drejtojë.

Gradualisht, dalë nga dalë,
zbriti i shenjtë Kur'an,
zbritën rregulla e ndalime,
të gjitha ishin të dobishme
për jetë të njeriut të përditshme...

Miftar. AJDINI Kl. V.

QËLLIMI I JETËS SË NJERIUT NË KËTË BOTË

Njeriu si dhe jeta e tij është temë e cila i ka preokupuar shumë dijetarë, filozofa si dhe njerëzit e rendomtë. Të gjithë ata i kanë parashtrua vedit pyetje, poashtu edhe sot i parashtrojnë. Ku është vendi adekuat i njeriut në këtë planet ku përpos tij jetojnë dhe zhvillohen me mija gjallesa tjera? Çka don të thotë jeta e njeriut në këtë botë? A thua njeriu në vazë të proceseve biologjike lind sot, që të vdesi nesër? Pse njeriu vehtës ia humbë qëllimin e jetës së tij dhe humbë në errësirën e pa fund që ia parashtron jeta në praktikë dhe në këtë mënyrë e shkurton afatin e jetës së vetë e cila edhe nga vetvetiu është e shkurtër? A thua njerëzit e bëjnë këtë pse janë të pa aftë ti përballojnë grushtit jetësor, apo për atë se nuk e njohin qëllimin e jetës së tyre?

Këto janë vetëm disa nga pyetjet e shumta të cilat kanë të bëjnë me jetën në këtë botë.

Do të përmendi prej dijetarëve të mëdhenjë vetëm Paskallin, si dijetarë, filozof dhe fetarë i cili lidhur me këtë temë (temën e jetës) mendon dhe thotë: »Kur e vështroj jetën time të shkurtër në këtë botë, humbëm në të kaluarën e saj dhe në të ardhmen e saj të përhershme, në hapsirën e ngushtë që e zë... më kaplojnë të dridhurat dhe frika dhe mendohem pse jamë këtu e jo në ndonjë vend tjetër. Kush më ka vendosur këtu? Me urdhërin e kuj dhe në bazë të çkahit më është caktuar koha dhe vendi«.

Ai vetë përgjigjet në pyetje dhe thotë: »Në mes të parajsit dhe ferrit është jeta e jonë e cila fluturimthi kalon. Këtë pyetje ndryshe duhet drejtuar pabesimtarit, e në mënyrë tjetër ati i cili beson sepse materialisti ka tjetër mendim, mendon se me vdekjen e tij çdo gjë merr fund. Kurse në anën tjetër besimtari është i bindur se pas vdekjes kalon prej jetës materjale në atë të amshuar dhe shpirtërore.

Këtu duhet bërë një vështrim mbi atë se çka duhet të jetë qëllimi i kësaj jete për besimtarin i cili beson Zotin dhe ringjalljen pas vdekjes.

Gjithçka që ekziston në këtë botë, ka edhe qëllimin e vetë. Në lidhje me këtë Zoti xh. sh. thotë: »Na nuk e krijuam as tokën e as qiellrat dhe atë që gjindët në mes tyre

pa qëllim« (Kaptira Duhanvërseti 38.). Kur gjithçka që ekziston e ka qëllimin e vet, është e pa mundur të shmangëmi nga pyetja që na parashtrohet në lidhje me jetën e njeriut dhe qëllimin e saj. Pse Zoti e dërgoi në këtë botë dhe çfarë rroli i dha të kryej në të? Përgjigjen në këtë pyetje do ta kërkojmë në Kurandin famëlartë, ku Zoti xh. sh. thotë: »Unë do të krijoj në tokë zëvendës« Kap. Bekare, v. 30. Nga ky artikull kuptojmë se njeriu është qenja më e përsosur në këtë botë dhe çfarë rroli i dha të kryej në të? dës në tokë. Ai është obligim dhe rrol mjaft i rëndësishëm si shihet prej vërseti vijues: »Na u ofruam obligimin qiellrave, tokës, maleve, por nuk deshtëm ato të mos i përgjigjen obligimit (të mbajnë barrën e obligimit pa e kryer), iu friguan devijimit, njeriu pranoi të jetë devijuas, vërtetë ai është zullumqar dhe i padijshtëm«. Prej këtij vërseti të cekur të Kuranit kuptojmë se njeriu pranoi obligimin që të sundoi këtë botë, që sipas dëshirës dhe nevojës ta shfrytëzoi dhe ndryshoi, natyrishtë brenda kufijve të mundësive të tij.

Iu besua mision i lartë. A do të mund ta kryej a do ta devijoi obligimin?

Kjo varet prej vet njeriut dhe asaj se si do ta shfrytëzoi jetën e shkurtër të kësaj bote, e cila është mashtruese, e cila është »urë e siratit e vërtetë« mbi të cilën kalohet, në të cilën bihet e për të cilën Zoti xh. sh. thotë: »Jeta e kësaj bote është vetëm defrim dhe lojë. Kurse me të vërtetë shtëpia e amshuashme është jetë e vërtetë«.

Kap. Ankebut v. 64..

Duke patur parasysh shpejtësinë e kalendarit të kësaj bote, ithtarët e disa religjioneve propagandojnë largimin prej çdo aktiviteti në këtë botë, duke ia mbathur botës së amshuar. Ja çka thotë Kurani në lidhje me këtë: »Dhe kërkoje botën e ardhëshme në atë që Zoti ta mundësoi, kurse mos harro kontibutin tënd në këtë botë«. K. Kasas, v. 77.

Nga ky citat i Kuranit shihet qartë se nuk lejohet lënja pas dore e kësaj bote në emër të së ardhëshmës, por përkundrazi, obligohemi që të kërkojmë vendin dhe pozitën në të, të shërbëmi me begatitë dhe buku-

ritë e saj. Vetë logjika flet që nga kjo botë varët fati ynë në botën e ardhshme, sepse kjo botë është si urëkaluese për botën e ardhshme. Në lidhje me këtë M. a. s. thotë: »Kjo botë është një kopshtë i botës së ardhshme«. Nga hadithi i cituar shihet dukshëm se në këtë botë kalitet fati i ynë i përhershëm. Për këtë arsye, pra duhet të mirret qëndrim i drejt. Islamizmi nuk e përkrah fanatizmin dhe njeriun fanatik, përkundrazi ai e urren jetën e këtillë. Jeta e këtillë na ka lënë prapa, pasojat e së cilës ende vërehen (ndihen). Megjithatë, pasi që njeriu është i ndërtuar në aspektin shpirtëror dhe material, patjetër ai gjatë jetës së tij duhet të ushqehet nga të dy aspektet. Duhet të plotësohen nevojat materiale që të mund të qëndrojnë fizikisht, e me të na xis edhe jetën shpirtërore. Sepse »Në trup të shëndosh është edhe shpirti i shëndosh«. Gjithashtu nevojitet edhe shpirtërisht të ushqehemi, në mënyrë që përveq kënaqësive materiale, të arrijmë qetësinë dhe defrimin shpirtëror. Në mes të shpirtit dhe gjërave materiale, duhet të kërkojmë mesatarën, të mos e lëjmë pas dore as njërën as tjetrën, por duhet shfrytëzuar edhe njërën edhe tjetrën. Nëse në plotësimin e kërkesave materiale, tejkalojmë kufirin, atëherë do të nivelizohemi me qenjet tjetra, të pa ndjenja, të cilat jetojnë vetëm në aspektin e jetës materiale.

Për ata të cilët gjejnë të vetmën ëndje në materje Zoti xh. sh. thotë: »Nëse kërkon (të mbledhë) frytet e kësaj bote, do ti japim diç prej asaj, por nuk do të ketë proporcion në botën e ardhshme«. Kaptira »Shuara« v. 20.

Pyetim se kush do të jetë i gatshëm që të sakrifikoje fatin e përhershëm në favor të kësaj jete të shkurt? Besimtari i vërtetë me siguri nuk do ta bëjë këtë.

Pra për atë në këtë jetë duhet menduar për jetën e përhershme dhe për fatin tonë. Iu admirohem bukurive të kësaj jete. Çfarë bukurie! Çfarë harmonije?!

Por kjo është vetëm një pjesë e vogël e bukurive që i krijoi Zoti xh. sh. Çka ka më tutje? Çfarë bukurishë?! Pa tjetër duhet të meritojmë të Zoti të na i zbuloi këto bukuri. Meqenëse në vehte kemi edhe anën shpirtërore, këtë Perendia e cek me fjalë: »Pastaj i dha formë (të njeriut) dhe e frymëzoi atë nga fryma e tij«. K. Sexhde vërseti 9.

Kemi mundësi që të i afrohem Zotit, që ta zbulojmë bukurinë dhe madhërinë e tij, por nëse këtë e meritojmë. Kjo do të ishte

gëzimi dhe lumturia më e madhe për njeriun. Për këtë duhet menduar në këtë jetë. Të mendojmë dhe të përpiqemi që të i afrohem Zotit xh. sh. që fytyrat tona të jenë të ndritura dhe të pastërta. Në të vërtetë në çdo namaz e adhurojmë Zotin me vërsete të Kuranit: »Sunduasi ynë! Na jepë të mira në këtë botë, po njëherit edhe në të ardhmën«. Këto janë fjalë me të cilat lypim të mirat në të dy botërat. Këto duhet ti kërkojmë edhe me veprat tona. Atëherë me siguri lutja do të plotësohet, ajo gjithqysh do të jetë parollë e jetës, përfundimi i qëllimit. Ajo për çka jetojmë, të mira në të dy botrat. Po si ta mbërrijmë atë? Vetëm me punë këmbëngulëse. Kur themi me punë, qëllimin e kemi të puna në rrugë të Zotit xh. sh. e jo në emër të djallit të mallkuar. Nëse punojmë në rrugë të Zotit, ajo don të thotë se punojmë në interes të përgjithshëm, për të mirat e njerëzisë.

Ne nuk kemi ndonjë peshojë speciale që të i peshojmë cilësitë njerzore, kjo është punë e të Gjithfuqishmit, por do të shpërblehemi me thënjën e M. a. s.: »Më të mirat njerëz janë ata të cilët iu shërbejnë njerzve, kurse më të kqijt janë ata të cilët janë damtuas për njerzit«.

Nëse mendojmë ti ndihmojmë njerëzve dhe të e fitojmë përfundimin e fatit, patjetër duhet të shfrytëzojmë maksimalisht jetën e shkurtër të kësaj bote, Nuk guxojmë prej asaj të largohemi. Ofanzivë e jo defanzivë. Më mirë është që vazhdimisht dhe në mënyrë sistematike të punojmë për të mirën e përgjithshme, po edhe nëse gabojmë duke punuar, është më mirë se sa të qëndrojmë duarkryq duke u mbrojtur prej mëkateve, sepse pasiviteti do të jetë gabimi-mëkati më i madhë.

Interesi i përgjithshëm ta sundoi interesin personal. Me punua edhe atëherë kur ekzistojnë kushtet objektive që puna të mos mund të përfundojë, sepse ate e përfundon tjetri sipas mendimit të mendimtarit të madhë hindian Xhavaharlla Nehru, i cili thotë: »Njeriu duhet që ta filloi punën, kurse nuk është e thënëur ta shohi përfundimin e saj«.

Duhet të punojmë duke mos pritur frytet e punës. Është e udhës që ti përkujtojmë disa dijetarë që i kanë kontribua njerzimit, të cilët jetuan me vite në sëndërgjimin (çpikjën) e tyre, duke e ditur se ato i ndihmojnë njerzimit, ato e shpëtojnë njerzimin. Ajo është jetë. Nuk u kënaqën me gjërat e imta të kësaj jete.

Ato rrojnë edhe pas vdekjes së tyre, si p. sh. N. Tesla i cili në pyetjen: pse nuk i lufton ata të cilët deshirojnë ti përvehtësojnë zbulimet tua:

»Unë nuk punoi për vehte, por për njerzinë. Kryesore është që progresi njerzor të shkoi përpara«.

Don të thotë, të punosh dhe luftosh për të mirë, nëse deshiron fat. Lufta i jepë jetës qëllimet e veta. Pa te jeta do të ishte e atrofizuar. Që njeriu të mund të luftoi duhet të jetë i fortë, e me ndjenja të forta shpirtërore. Atëherë nuk do të shtrohej pytja për çka disa njerëz e ndërprejnë fijen e jetës së vetë. Poeti i madhë Ernest Hemingvej thotë:

»Njeriu mund të jetë i rrënuar, e kurrësi i thyer-shtangur«. Ska dyshim se s'ka mendua, për njerzit e lartë përmendur, por në ata të cilët e kalojnë jetën me forcë.

Në fund vlen të i theksojmë fjalët e z. Aliut r. a.:

»Puno për këtë botë, ashtu sikur do të jetosh gjithmonë e (menddo) puno për botën e ardhshme, sikur do të vdesish nesër.«

Bëna të mundur o i Gjithfugishëm që të jetojmë nën influencën e këtyre fjalëve, sigurishtë do të shkonim me hapa të shpejtë përpara, në një ardhmëri të sigurtë...

SELIM RASHIDI KL. —V—

DASHURIJA NDAJ ZOTIT Xh. Sh. DHE FESË ISLAME

Meqenëse njeriu është krijuar prej dy elementeve; shpirtit dhe trupit, ati i nevojitet edhe ushqimi për te. Sa i përket anës lëndore, ajo ushqehet me gjëra ushqimore, ndërsa ajo shpirtërore si ushqim dhe mbështetje ka fenë.

Zoti xh. sh. njeriun e krijoj në mënyrë më të përsosur nga gjallesat tjera, prandaj ai duhet ta falenderoj Zotin për të mirat që ia ka dhurua. I vetmi ushqim dhe më i miri për shpirtin e njeriut është feja. Feja për njeriun është gjithçka;

E vetmja fe që është e pranuar te Zoti xh. sh. është feja islame; e cila iu dhurua njerzimit prej njeriut dhe profetit të parë Adem-it a. s. e që vazhdon edhe sot. Të gjithë profetët e predikuan të njëjtën fe, edhe pse mënyra e jetës, sipas kushteve, rrethanave, nevojës ndryshonte, bazat e saj mbetën të njëjta për të gjithë profetët, si p. sh. predikimi në Zotin një, besimi në ringjallje etj.

Ja edhe një vërsel i Kur'anit famëlartë: »INNE DDINE INDALLAHILL ISLAM«. që don të thotë: »Më të vërtet te Zoti xh. sh. fe e vërtet është vetëm feja islame«. Ky vërsel na jep të kuptojmë se ndër të gjitha tjerat, feja islame është lartë.

Ta duash fenë islame don të thotë; ta duash Zotin xh. sh., profetët e tij e posaqërshtë Muhamedin a. s. Dashurija në Zotin xh.

sh. manifestohet në zbatimin e urdhërave të tij e me këtë shprehim edhe dashurinë ndaj tij, përndryshe nese veprojmë të kundërtën, aherë kuptohet se nuk e duam ate (Zotin).

Perendija prej nesh kërkon që dashurija ndaj Tij dhe Profetit të jetë më e madhe se çdo send tjetër në natyrë si psh. më e madhe se; dasurija e nënës, babës, fëmijut e tj.

Me një hadith tjetër profeti a. s. na këshillon: »LA JU MINU EHADUKUM HATTA EKUNE EHABBE ILEJHI MIN VALIDIHI VE VELEDIHI VE NNASI EXHMEIN«. Nuk është besimtarë i vërtet asnjëri prej jush gjersa të bëhem unë te ai më i dashur prej: prindërve të tij, fëmijëve të tij dhe prej të gjithë njerzve në përgjithsi«.

Një njeri që nuk ka dashuri ndaj Zotit xh. sh., ai nuk ka fat e as lumturi në këtë botë, sepse fati varët prej besimit të tij.

Duhet ditur se muslimanët e parë sikur mos të kishin patur sinqeritet dhe dashuri ndaj Zotit xh. sh. nuk do të mundshin ta përhapin fenë islame. Për dashurinë që patën muslimanët ndaj fesë islame, ata për hirë të saj në rastë nevojë sakrifikuan edhe jetën, andaj edhe ne duhet ndjekur rrugën e tyre.

Abdil-Sami MISIMI KL. V.

ME MATURANTAT E MEDRESËS SË MESME „ALAUD-DIN”

Sikurse çdo vit tjetër edhe kësaj here (këtë vit) 1975, medresa përcolli gjeneratën e tetë të maturantëve të saj. Kishin ardhur këtu, saktë para pesë vjetësh, që të njoftohen me njeriun dhe zhvillimin e tij, që të jetën kështu kushtojnë Zotit dhe fesë. Para plotë pesë viteve patën ardhur nga të gjitha viset, duke mos njohur njëri tjetrin. Koha e bëri të vetën, që ata në të ardhmën, të jetojnë një jetë vëllazërore dhe së bashku të luftojnë kundër armikut të vetvehtës për sukseset e veta të mëtejme dhe për të nesërmën e tyre.

Të tubuar nga të regjionet e vendit tonë, prej fillimit e gjer në fund, kanë kultivua pëlqim dhe shoqëri gjer në ditën e fundit, ku këtë të gjithëve ua kanë demonstrua. Që të mujmë më mirë të njihemi me çfarë përpjekjesh dhe vullneti maturantët e sivjemë kanë arritur fundin e shkollimit të tyre, po sjellim rendin e tyre sipas abeces me shenjat e fshatrave të tyre e komunave si dhe suksesin e arritur.

Këtë po ua paraqesim në formë të tabelës e që për afërsisht do të dukej kështu:

Emri e mbiemri i nx.	fshati	komuna	suksesi
1. Abdulbari Halili	Zhelinë	Tetovë	me një të dobtë
2. Abdullah Rexhepi	Kalishte	Strugë	mirë
3. Ali Aliti	Prizren		mirë
④ Ali Qerimi	Velika reka	Podujevë	sh. mirë
⑤ Binak Tolaj	Prilep	Deqan	mirë
⑥ Dibran Hoti	Bradash	Podujevë	mirë
7. Esat Rexha	Gjakovë		me një të dobtë
8. Hysen Ajeti	Llovcë	Gjilan	me një të dobtë
9. Hysen Hetemi	Sllatinë	Tetovë	sh. mirë
⑩ Isak Qamili	Odër	Tetovë	sh. mirë
11. Ismet Aliju	Përshevcë	Tetovë	sh. mirë
12. Itaxhudin Ibrahim	Zgatar	Dragash	sh. mirë
13. Itaxhudin Salihu	Bogovinë	Tetovë	sh. mirë
14. Kadri Dërguti	Rahovec		mirë
15. Llukman Geci	Llaushë	Sërbicë	me dy të dobta
16. Maliq Mustafa	Brodosanë	Dragash	mirë
17. Muharrem Ukshini	Llovcë	Gjilan	mirë
18. Mustafa Hasani	Bojanë	Shkup	mirë
19. Musli Musliu	Pogragjë	Gjilan	shkëlqyeshëm
⑳ Nehat Krasniqi	Brezne	Dragash	sh. mirë
㉑ Nuredin Ahmeti		Tetovë	mirë
22. Nuri Rexhepi	Korqullë	Vollandovë	me dy të dobta
23. Osman Zogaj	Kravarë	Ulqin	shkëlqyeshëm
24. Rexhep Osmani	Gllumovë	Shkup	sh. mirë
25. Ramadan Emini	Kuk	Dragash	sh. mirë
②⑥ Hakim Hoxha	Radolishtë	Strugë	mirë
27. Qerim Rexhepi	Krushevo	N. Pazar	mirë
②⑧ Sefedin Kaqapori	Orle	Tutin	shkëlqyeshëm
29. Sylejman Hajdari	Kosiqë	Ulqin	mirë
30. Sami Kasami	Brodosanë	Dragash	sh. mirë

31. Shaip Ymeri	Stançiq	Gjilan	sh. mirë
32. Xhafer Baxhaku	Prizren		me dy të dobëta
33. Xhemil Ballazhi	Pustinë	Kaçanik	shkëlqyeshëm
34. Zijadin Ajadini	Kuk Dragash		mirë
35. Tahir Kacaj	Martiq	Bar	mirë
36. Mehmet Gjokaj	Dinosh	Titograd	shembullor



Numri i përgjithshëm i maturantave të sivjemë është 36, të cilët e kryen rregullishtë vitin shkollor. Duhet theksuar se maturantat e sivjemë si zakonishtë më së shumti ishin nga Kosova, gjithsejtë 19., nga Maqedonija II., nga Mali i Zi 4 dhe nga Sangjaku 2. Prej këtyre dy e kanë kryer afatin ushtarak, kështu që ata pas armatës iu kanë bashkua shokëve të tyre, gjer ahëre të ardhshëm.

Sa i përket gjat maturimit nuk ka patur rast që ndonjëri prej tyre të ndërprej shkollimin e rregullt për shkak të shërbimit ush-

tarak. Për këtë më së tepërmi duhet falenderua pushtetin popullorë i cili u ka mundësua mbarimin e shkollimit pa ndërprerje. Mesatarja e moshës së maturantave të sivjemë është 20 vjetë, respektivisht shumica e tyre janë të lindur në vitin 1955.

Në pyetjen ku pas maturës, muarëm përgjegje mjaftë interesante. Sikur që dijmë, nxënësit e medresës, sikur dhe të gjithë nxënësit e shkollave fetare, nuk kanë të drejtë për shtyrjen e afatit ushtarak, kështu që të gjithë kanë shprehur frigë që të mos shkojnë

menjëherë në shërbimin ushtarak. Me vet anketën si përgjegje të parë kemi marrë, në pyetjen ku pas maturës, »Nese don Zoti, pas maturës mendoj të shkoj në ndonjë nga vendet arabe, për të përvehtësua gjuhën arabe. Shumica e kandidatve nëse ju plotsohet dëshira do të vazhdojnë në vendet arabe ku kishin me studjua. Gjithashtu ka pas përgjegje, që ka edhe të tillë të cilët do të vazhdonin në ndonjë fakultet të vendit. Ndërsa pakica janë prej atyre të cilët do ti shërbejnë besnik

popullit të vetë, i cili i ka ndihmua në mënyra të ndryshme për kryerjen e punës së filluar, respektivisht, të mbetën në funksion islam (imam). Andaj nga ky anketim, mund të konkludojmë se shumica prej tyre deshirojnë të vazhdojnë rrugën edhe më tej për kërkimin e diturisë, të cilën edhe vet Muhamedi a, s. e ka porosit. Më në fund të gjithëve iu deshirojmë sukses të plotë në çdo lëmi.

CEREMONIJA ME RASTIN E MBRËMJES SË MATURËS

Maturantat e sivjemë, të medresës së mesme »Alaud-din« përgatitën të hënën në mbrëmje, pas nazit të akshamit, mbrëmje solemne me rastin e kryerjes së shkollimit të tyre pesëvjeçarë në medrese.

Në mbrëmje përveç nxënësve, të pranishëm ishin edhe mësimdhënësit e tyre, ku në shej gëzimi dhe hareje, njëkohësisht edhe pikëllimi, së bashku në mënyrë shoqërore i kaluan orët e fundit në medrese.

Në sajë të kësaj, që në fillim të ceremonisë, duke i falenderuar të gjithë prezentuesit e mbrëmjes së maturës, fjalën e mori drejtori i shkollës H. Sherif Ahmeti. Ai në fjalimin e tij pos tjerash theksoi edhe sukseset e arritura gjatë viteve të kaluara, në të cilat maturantat treguan sukses të kënaqshëm... e në mbarim të gjithëve iu deshiroj sukseset e fat në të ardhmën. Pas kësaj nxënësit me leximin e Kuranit, e bënë edhe më atraktive atmosferën, së pari Mustafa Hasani dhe Xhemil Ballazhi lexuan nga një pjesë (ashere) të Kuranit, e pastaj grupi i nxënësve lexuan

»kaside« të ndryshme në shej të mbarimit të pjesës së parë të këtij tubimi. Pjesa e dytë kaloi duke biseduar në mes veti dhe duke u freskuar me pije joalkoolike. Në bisedë e sipër shumicës prej tyre u rridhnin lotët nga mallëngjimi, duke kujtue e gjithë atë, të cilën shoqërishtë dhe vllazërishtë e kanë kaluar gjatë kësaj jete të përbashkët. Ishte gëzim në atë natë, si asnjherë tjetër, kishte shakara, këngë dhe valle. Qëndruam aty gjerë vonë në mbrëmje, ku hareja mbi të gjitha dominonte. Në fundë, me lotë dhe përkëdhelje erdhi rasti kur njëri tjetrit i shtrinë duartë duke i deshirua suksese sa më të mira tani e pas, me dëshirë që edhe një herë të gjëndën të bashkuar dhe së bashku ti zgjidhin problemet, të cilat iu paraqitën. Për shumë kohë do të na mbetët si kujtim kjo mbrëmje e maturës, e cila kaloi në atmosferë këndshme. Edhe një herë, të gjithëve iu deshirojmë sukses!

Adem ZILKIQI Kl. V.

SHPËRNGULJA-HIXHRETI I MUHA- MEDIT A.S. PREJ MEKE NË MEDINE

Ishte viti i trembëdhjet i nubuvetit (profetizmit). Shumica e shokve të Muhamedit ishin të shpërngulur edhe më parë. Shumë pak kohë kishte kalua prej Miraxhit. Muhamedi a. s. me urdhrin e Zotit xh. sh. pruri vendimin për tu shpërngulë nga vendlindja. Pati edhe disa signale më parë në kaptirën »Isra« për shpërngulje.

Shpërngulja e Profetit a. s. është një ngjarje me rëndësi në historinë e tër muslimanve të botës. Në Medine dita-ditës shumzohej numri i muslimanve, të cilët e pritnin me padurim Muhamedin a. s.. Paria Kurejshite e dinin se Muhamedi a. s. do të shpërngulët, andaj u orvatën me çdo kushtë që ta pengojnë dhe tentuan të bëjnë atentat. Një natë u mblodhën në shtëpinë e quajtur »Daru nedve«, e kjo ishte e Kusa bin Hakimit; Utbe, Ebu Sufjan, Xhubejr bin Mutani, Ibën Hishami, Hakim bin Hizami, Ebu Xhehli dhe shumë të tjerë krer të familjeve, në të cilën mledhje dhanë mendime të ndryshme. Mendimi më i mirë e njëherit edhe që u aprovua ishte i Ebu Xhehlit, i cili tha: »Prej sejcilit fis të dalë nga një njeri, ku tha se të gjithë përnjëherë të bëjnë atentat mbi Muhamedin a. s.«. E prunë këtë vendim, për arsye se Hashimit nuk do të mund të hakmירren me të gjitha fiset. Menjëherë pas kësaj u zgjodhë nga një njeri prej të gjitha fiseve, numri i të cilëve arriti në katërdhjetë. Në mesin e tyre ishin edhe këta: Ebu Lehebi, Ebu Xhehli, Hakem bin Asi dhe Umejje bin Halefi.

Xhibrili, me dashurinë e singert ndaj Muhamedit a. s. e lajmëroi për këtë qështje. Fill pas kësaj Profeti a. s. e thirri Aliun r. a. e i tha: »O Ali! Unë me urdhërin e Zotit xh. sh. po shpërngulëm në Medine, ti në këtë natë duhet të biesh në shtratin tim, ua shpërndanë amanetët pronarve të tyre dhe pastaj eja edhe ti në Medine«!.

Aliu r. a. ra në shtratin e Muhamedit a. s. dhe u mbulua me mbulesën e gjelbër të M. a. s.

M. a. s. prej toke një grushtë rër e muar. Prej »jasinit« disa vërsete i lexoi. Mbi mushrikët e gjuajti atë grushtë rër dhe prej mesit të tyre dual e shkoi.

Mushrikët mendonin se në shtrat është duke fjetur M. a. s. Kur mëngjesi agoi, ata u vërsulën në dhomë ku kishte qëndruar M. a. s., mirëpo kur e panë që është Aliu r. a., ati me ton të lartë i thanë: Ku gjindet Muhamedi? Ai tha: »Nuk e di«! Pastaj Aliun r. a. e muarën, e mbyllën në burg dhe filluan të kërkojnë M. a. s. Të gjitha rrugët e Mekës i kërkuan, por asesi nuk e gjetën.

Mbarimin e kësaj ngjarje mund ta kuptojmë më së miri nga Buhariu i cili i interpreton fjalët e Aishës r. a. dhe thotë: »Edhe Ebu Bekri r. a. si shokët tjerë ishte i pregatitur për tu shpërngulë, por M. a. s. i tha:

— Ke durim! Edhe mua për shpërngulje nga ana e Zotit xh. sh. shprehsoj se do të më vij leja. Pastaj Ebu Bekri vazhdoi:

— O Muhamed babai dhe nëna ime juve ju bëfshin kurban! Për lejën e kësaj a shprehson? E M. a. s. tha:

— Po shprehsoj, duke vërtetuar tha. Në këtë rast Ebu Bekri u shmangua nga ajo që të shpërngulët, pa i ardhë leja Profetit nga Zoti xh. sh.«

Në shtëpinë e Ebu Bekrit gjindëshin dy deve të cilat i kishte ushqyer Ebu Bekri katër muaj. Për këtë Aishja r. a. thotë: »një ditë pas muzgut ishim duke ndejtur në shtëpinë e Ebu Bekrit dhe natë rast erdhi një fëmi nga familja e tij dhe lajmëroi se po vjen Muhamedi a. s.«. Natë E. Bekri u përgjegjë: »Babai dhe nëna ime atij iu bëfshin kurban, sigurishtë do ti ketë ardhur ndonjë lajm i mirë, pasi që ai po vjen te na. »Profeti erdhi dhe kërkoi lejë nga ata për të hy brenda. Pasi iu dha leja Profeti hyri brenda dhe itha E. Bekrit që ti qes jashtë të gjithë ata që janë brenda, por E. Bekri iu përgjegjë duke i thënë: »baba i im ty kurban tu bëftë o Muhamed! Këta të gjithë janë bijtë e tu Pastaj E. Bekri M. a. s. i tha: O Ebu Bekër! U urdhërova të dalë nga Meka, e E. Bekri, shtoi duke thënë; edhe unë do të jamë në shoqëri me ju. Për këtë Profeti u përgjegjë: Po, natë moment E. B. i tha M. a. s. ta zgjedhi një-rën nga dy devët e tij. Muhamedi a. s. pranoi por vetëm me zëvendësim mund ti marr tha ai. Për këtë Aishja shtonë duke thënë: »Për Muhamedin dhe E. Bekrin të gjitha ishin të mundëshme (çdo gjë ishte në rregull) për të fillua rrugën. Pastaj M. a. s. dhe E. B.

dualën prej shtëpie dhe filluan rrugën për në shpellën e kodrës Thevr në të cilën u mshefën tri netë. Afër tyre qëndronte edhe i biri i E. B. Abdullahu, i cili gjatë ditës bënte hetime se çka po flitët ndër kurejshitët për Muhamedin dhe E. Bekrin, kurse në mbërëmje i informonte për çdo gjë të re. Aty në afërsi edhe rob i E. B. gjatë ditës i kulloste delet, e në mbrëmje u sjellte qumësht të freskët.

Pas tri netë qëndrimi në shpellë, djali i E. Bekrit ua solli dy deve dhe filluan rrugën. Për ti udhëzuar gjatë rrugës e morën edhe Abdullah ibën Urejkidin, pasi që ky e dinte rrugën më së miri.

Mushrikët ende e kërkonin Muhamedin a. s., bile Ebu Xhehli premtonte se kush e nxenë të gjallë M. a. s. dhe E. B. do ta shpërblej me 100. deve. Kur dëgjoi për këtë Hajme Neshim bin Mutlik tha se para dy ditëve i kamë parë tre persona me dy deve, pastaj Suraka bin Maliku tha se unë do të shkoj dhe do të sjellë Muhamedin të gjallë dhe iu vu prapa. Kur arritën në lagjën Kudej iu afërua, bile u afërua 10 metra afër tyre. E. Bekri filloi të frigohet. Muhamedi a. s. i dha kurazh

duke i thënë mos u deshpro se Zoti është me ne.

Në këtë rast Profeti bëri një lutje dhe ati i Surakës sharroi gjerë në gjuhë në ranë, Kur vëren këtë gjë Suraka iu drejtua M. a. s. dhe i tha: O. Muhamed lute Zotin tënd që të kthehëm dhe ti kthej ata që kanë fillua rrugën prapa teje.

Këta dy vazhduan rrugën gjersa arritën në vendin e quajtur Kuba afër Medinës, ku qëndruan katër ditë. Gjatë qëndrimit të tyre në Kuba, i nderuari Muhamed ia vuri themelin e xhamisë së parë në botën islame. Në kohën kur ishin ata aty mberrini edhe Aliu r. a., pasiqë i kishte shpërndarë emanetët pronarëve të vetë që ia kishin lënë në dorëzim Muhamedit a. s. Pas katër ditë qëndrimi në këtë vend filluan rrugën për në Medine. Nga Kubaja dolën në ditën e premtë dhe i zuri koha e namazit të xhumasë në rrugë. Atë ditë iu bë detyrë (farz) Muhamedit a. s. dhe gjithë muslimanëve të falin xhumanë. Pasi falën xhumanë vazhduan rrugën për në Medine, e atje arritën me 16 Rebiul evvel-20 shtator të vitit 622 të erës sonë.

HAMDI MORINA —V—

PËRSHËNDETJA ISLAME DHE RËNDËSIJA E SAJ

Të përshëndeturit në fenë islame është një detyrë shoqërore me rëndësi, sepse kur të përshëndetish ndonjë njeri tregohesh se je i sinqert ndaj tij, je një njeri që mund të shoqërohesh me njerëz të ndryshëm. Poqese nuk e përshëndet tjetrin, aherë tregohesh se je mëndjemadh dhe nuk je i sinqert ndaj shoqërisë. Të përshëndesish shokun dhe më të madhin jep të kuptojmë se nuk ke urrejtje ndaj tij.

E në lidhje me këtë Kurani thekson: »VE IDHA HUJJITUM BITEHIJJETIN FE-HAJJU BI AHSENE MINHA EV RUDDUHA INNE LLAHE KANE ALA KUL' LI SHEJIN HASIBAN«. »Kurdo që të ju përshëndet dikudh me një përshëndetje, përshëndetne ju më mirë se ai, ose si ai, se Perëndija është mbi çdo send llogaritës«.

Përshëndetja në islamizëm është synet kurse të marrurit është vaxhib, por është vaxhibi kifaje që don të thotë: kur një për-

son përshëndet një grup njerzish, mjafton që ati ti përgjigjet vetëm njëri nga ata, e me te lirohen edhe të tjerët.

Për rëndësinë e të përshëndeturit kemi shumë thënje të Profetit a. s. të cilat na bëjnë me dije që të përshëndetim me selam e një e tillë thekson: » Shpërndani selam mbi ata musliman që i njihni dhe mbi ata të cilët nuk i njihni«. Të dhënit selam është një vepër e lavduar dhe ka shpërblime të mëdha, ndërsa të përgjegjurit e selamit ka shpërblim, por shpërblimi i tij është me vlefte më të ulët. Kjo është një prej atyre ngjarjeve ku syneti është më i lavduar se vaxhibi.

Pasi që kuptuam se duhet me përshëndet me selam të gjithë besimtarët, megjithatë ka raste kur nuk duhet dhënë selam, p. sh. selami nuk mund ti jepet ati i cili është duke lexua Kuran, ati i cili është duke e dëgjua ate, sepse është i okupuar me punë, të cilat e pengojnë ti përgjigjet selamit, e tj.

Xhevdet EMINI Kl. IV.

TREGIM

Shoku i Muhamedit a. s. me emrin Xhabir tregon një ndodhi nga jeta e Muhamedit a. s. Ai thot: një ditë Profeti a. s. ishte ulur për të pushua nën hijen e një druri, kurse shpatën e tij e vari në një degë të drurit. Pas pak çastesh pranë tij u gjinde një mushrik. Ai së shpejti e rrëmbeu shpatën nga dega dhe iu drejtua Muhamedit a. s. duke i thanë: »A më frigohesh?« »Jo!« iu përgjeggj Profeti i Zotit duke mos iu friguar aspak. »Kush po të mbron ty tash?« I tha përsëri mushriku. »Zoti i madh dhe fuqi plotë!« iu përgjeggj Profeti duke mos iu friguar aspak. Kur e dëgjoi emrin e Zotit xh. sh. mushrikut i ra

shpata nga dora. Muhamedi a. s. e mori shpatën, atherë mushriku i kërkoi falje. Pasi u falë nga Profeti a. s. u nis për në shtëpi.

Kur arriti te fisi i tij ju tha: »pse nuk më pyetni, se nga vij unë? Unë jam takua me njeriun më të ndershëm e më të singert dhe më trim, dhe unë kthehem në fenë e tij. E ata iu përgjeggjën: »Të ka mashtrua djali i Abdullahut«. Ai iu tha: Jo nuk më ka mashtrua; por ma fali jetën. Pastaj ai ua tregoi ngjarjen që i kishte ndodhur më par me Muhamedin a. s.

Qefli Osmani kl. - IV -

UPRAVI SREDNJE „ALLAHUDDIN” MEDRESE (cenjenom gospodinu di- rektoru Hadži Mula Šerif ef.)

P R I Š T I N A

Htio bih da u ime Odbora Islamske zajednice u Titogradu i u svojstvu kao vjersko-prosvjetni referent i ime mojih džematlija napišem Vama o Vašem učeniku SELIM ZEČIRA koji je završio II. raz. kod Cijenjenog Naslova, a sada se nalazi na praksi uz Ramazani šerif u svojstvu muezima »STARODOGANJSKE« džamije u Titogradu. Ostavio je najlepší utisak na sve nas. U njemu smo za ovo kratko vrijeme vidjeli čovjeka vjerna i dosledna svom pozivu. Prema njegovim školskim kvalifikacijama veoma sposoban. Lijep, mekan glas i kiraet — učenje pravilno Kur'an kerima, dovele su mnoge džematlije i do suza radosnica a posebno mene kao imama koji se priseća školskih klupa iz Medrese i znoja koliko Vi sa ostalim Cijenjenim Nastavničkim kolegijumom ulažete truda i znoja da prenesete na iste ono što su na Vas prvi prenijeli. O njegovom radu i disciplini može se reći i ocijeniti sa visokom ocenom čistom peticom.

Vrijeme koje je proveo među nama bilo je kratko, ali i pored toga vrlo i uspješno.



Selim Zečiri

Zavoleli su ga i najmladi džematlije — polaznici vjerske obuke kojima je u spriječnosti imama, predavao i vrlo uspješno prenio na najmlađe ljubav prema Islamu i njegovim propisima. Posebno svijuh nas je radovalo što se lijepo i primjerno ponašao. Posjedovao je pravi AHLAK jednog budućeg velikog alima.

Kao mlad lijepo se i pristojno oblačio i pristojno bio potišan, što je lijep dojam i primjer ostavio kod mladog džematlije.

Svi smo se rastali s njime istinskom tugom, ali smo ipak bili zadovoljni u duši, što ima i takvih učtivih učenika kod Cijenjenog Naslova koji bi ostalim učenicima trebao da služi za primjer i kao takvog do sada od svih Vaših učenika, ovaj je ponio najbolju ocenu.

Poželeli smo mu sve najbolje, jer on to i zaslužuje, i ujedno ga zamolili da ovaj traserani put koji ste mu Vi gos. direktore kao

i njegovi roditelji dali, nastavi bez obzira na sve poteškoće — prepreke koje će mu u toku školovanja i njegove službe naići.

ZAISTA GOSPODINE DIREKTORE, MOŽETE BITI PONOSNI OVAKVIM SVOJIM UČENICIMA.

Na kraju izvinite što vam oduze slobodno vrijeme sa ove par riječi, želim Vama i Vašem kolektivu kao i svim učenicima uspjeh u poslu, dobro zdravlje i UPUĆUJEM DOVU ALLAHU DŽ. Š. DA VAS ZA ULOŽENI TRUD I DOSTOJNO NAGRADI. A MIN.


Uz m. selam sa čestitkom
želim Vam

»BAJRAM MUBAREK OLSUN«

SEKRETAR
I VJER. PROS. REFERENT
(H. HALIL SEFEROVIĆ)



FJALËKRYQI I NURIT



Horizontalisht: 1) Një libër i shenjtë 6. Emri i profetit tonë 8. Pak (sër.) 9. Emër i filozofit islam Abas II. Godina mbi të cilën kalohet 12. Mbajtja në një anë 13. Pyetëse sasie 14. Lum në BRSS 15. Më ep 16. Një kryeqytet fqinjë 18. Kampioni 19. Lloj peshku 20. Vendlindja e profetit 21. Pluhuri (lëngu) që thithë bieta 23. Vend ku ranë në konflikt grekët dhe turqit.

Vertikalisht: 1. Kështjella 2. Një organ (sër) 3. Zoti i egjiptasve të vjetër 4. Kryeqyteti i Jordanit 5. Disa (sër) ose dikush 6. Vrapimi i gjat 7. Qytet në Siri 8. Libër i shenjtë 10. Veshje femrash fshatare 12. Zhguna (turq.) 14. Të atillë (sër.) 17. Jo i mirë 18. Lloj ngjysi 20. Grabis dhe 22. Dy bashkëtingllore.

Miftar AJDINI



پیرام مبارک اولسون

